L I G J
Nr.8770, datë 19.4.2001

PËR SHËRBIMIN E RUAJTJES DHE TË SIGURISË FIZIKE

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K UV E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Neni 1

Shoqëria e ruajtjes dhe e sigurisë fizike ka për mision:

a) sigurimin e objekteve publike e private në pronësi ose në përdorim të personave fizikë e juridikë, që ushtrojnë veprimtari në Republikën e Shqipërisë;

b) sigurimin dhe mbrojtjen e jetës dhe të shëndetit të personave fizikë, shtetas shqiptarë ose të huaj;

c) shoqërimin e vlerave monetare e materiale ose të sendeve të çmuara gjatë transportimit të tyre.

Neni 2

1. Shërbimi i ruajtjes dhe i sigurisë fizike kryhet nga subjekte private të organizuara në shoqëri tregtare nga shtetas shqiptarë ose në bashkëpunim me shtetas të huaj, të licencuar për këtë qëllim, të cilat plotësojnë kushtet e përcaktuara në legjislacionin për shoqëritë tregtare dhe në këtë ligj.

2. Shërbimi i ruajtjes dhe i sigurisë fizike kryhet nëpërmjet marrjes së masave teknike-administrative për mbrojtjen e jetës së personave, të objekteve publike ose private, në pronësi ose përdorim të personave juridikë ose fizikë, shqiptarë ose të huaj, si dhe për ruajtjen e sigurimin e vlerave monetare e materiale ose të sendeve të çmuara gjatë lëvizjeve.

3. Me punonjës shërbimi të shoqërisë së ruajtjes dhe sigurisë fizike kuptohet çdo shtetas shqiptar i pajisur me leje dhe armatim nga organet e Policisë së Shtetit, për të kryer shërbim në ruajtjen dhe sigurimin e objekteve publike dhe private.

4. Ruajtja dhe sigurimi i objekteve publike dhe private bëhet vetëm nga shoqëritë e krijuara dhe të licencuara për këtë qëllim.

Neni 3

1. Për ushtrimin e veprimtarisë së ruajtjes dhe të sigurisë fizike, shoqëria pajiset me licencë të lëshuar nga organi kompetent i përcaktuar në këtë ligj.

2. Licenca jepet pasi shoqëria të jetë regjistruar në regjistrin tregtar dhe të ketë përcaktuar në aktin e themelimit drejtuesin teknik. Ajo jepet me afat njëvjeçar, me të drejtë përtëritjeje, kur nuk kanë ndryshuar kushtet e dhënies së saj.

Neni 4

1. Licencat, në varësi të llojit të shërbimit, klasifikohen:

a) të kategorisë "a" që është e vlefshme për ruajtjen dhe sigurimin fizik të objekteve publike dhe private;

b) të kategorisë "b" që është e vlefshme për sigurimin fizik, mbrojtjen e jetës dhe të shëndetit të shtetasve, vendas dhe të huaj;

c) të kategorisë "c" që është e vlefshme për shoqërimin e vlerave monetare e të sendeve të

çmuara.

2. Shoqëritë, me kërkesë të tyre, mund të pajisen njëkohësisht me licencë të kategorisë “a” dhe “b” (“a+b”).

3. Për nxjerrjen e licencës së kategorisë “a”, shoqëria duhet të ketë një kapital fillestar jo më të vogël se 2 000 000 lekë dhe drejtuesi teknik i zgjedhur duhet të ketë një përvojë pune, jo më pak se 5 vjet në shërbimet e Policisë së Shtetit ose në shërbimet e ruajtjes dhe të sigurisë fizike të këtyre lloj shoqërive.

4. Për nxjerrjen e licencës së kategorisë “b”, shoqëria duhet të ketë një kapital fillestar jo më të vogl se 3 000 000 lekë dhe drejtuesi teknik i zgjedhur duhet të ketë një përvojë pune, jo më pak se 5 vjet në shërbimet e Policisë së Shtetit ose në shërbimet e ruajtjes dhe sigurisë fizike të këtyre lloj shoqërive.

5. Për nxjerrjen e licencës së kategorisë “a+b” shoqëria duhet të ketë një kapital fillestar jo më të vogël se 4 000 000 lekë dhe drejtuesi teknik i zgjedhur duhet të ketë një përvojë pune, jo më pak se 7 vjet në shërbimet e Policisë së Shtetit ose në shërbimet e ruajtjes dhe të sigurisë fizike të këtyre lloj shoqërive.

6. Për nxjerrjen e licencës së kategorisë “c”, shoqëria duhet të ketë një kapital fillestar jo më të vogël se 5 000 000 lekë dhe drejtuesi teknik i zgjedhur duhet të ketë një përvojë pune, jo më pak se 10 vjet në shërbimet e Policisë së Shtetit ose në shërbimet e ruajtjes dhe të sigurisë fizike të këtyre lloj shoqërive.

7. Ministri i Rendit Publik dhe Ministri i Financave të përcaktojnë me urdhër të përbashkët ndryshimin e vlerave të kapitalit fillestar, në përputhje me nivelin e inflacionit.

Neni 5

1. Shoqëritë e pajisura me licencë të kategorisë “a” ushtrojnë veprimtari brenda juridiksionit territorial të qarkut të përcaktuar në licencë.

2. Shoqëritë e pajisura me licencë të kategorisë “b”, “c” dhe “a+b” ushtrojnë veprimtari në të gjithë territorin e vendit.

Neni 6

1. Marrëdhëniet ndërmjet shoqërive të ruajtjes dhe të sigurisë fizike dhe të personit fizik a juridik që merret në ruajtje, rregullohen me marrëveshje të përbashkët, ku pjesë e saj duhet të jetë rregullorja e shërbimit dhe sipas rastit rregullorja e brendshme e objektit.

2. Marrëveshja nënshkruhet ndërmjet drejtuesit teknik të shoqërisë së ruajtjes dhe të sigurisë fizike dhe personit të autorizuar nga personi fizik a juridik që merret në ruajtje.

3. Rregullorja e shërbimit, që është pjesë e marrëveshjes së nënshkruar nga palët, hartohet sipas rregullores tip, të miratuar me urdhër të Ministrit të Rendit Publik.

Neni 7

1. Pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit krijohet Komisioni i Shqyrtimit të Licencave.

2. Kërkesat për marrjen e licencës sipas kategorive paraqiten pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, së bashku me dokumentacionin përkatës, të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Rendit Publik.

3. Komisioni i Shqyrtimit të Licencave e shqyrton kërkesën brenda 30 ditëve nga paraqitja e kërkesës dhe në përfundim i paraqet autoritetit lëshues vlerësimin përkatës.

4. Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit është autoriteti i ngarkuar për lëshimin e të gjitha kategorive të licencave.

Neni 8

1. Uniforma e punonjësit të shërbimit të shoqërive të ruajtjes dhe të sigurisë fizike është e njëjtë për të gjitha shoqëritë, por e ndryshme nga ajo e Policisë së Shtetit. Ajo përcaktohet me urdhër

të Ministrit të Rendit Publik.

2. Në uniformë vendoset dukshëm stema, e cila është e veçantë për çdo shoqëri. Stema miratohet nga organi licencues në çastin kur jepet licenca.

3. Ndalohet mbajtja e uniformës jashtë kohës së shërbimit.

Neni 9

1. Drejtuesi teknik i shoqërisë dhe punonjësi i shërbimit pajisen me armatim, municion dhe mjete speciale, të përshtatshme për kryerjen e shërbimit të ruajtjes dhe të sigurisë fizike.

2. Lloji e sasia e armatimit, e municionit dhe e mjeteve speciale, përcaktohen me urdhër të Ministrit të Rendit Publik.

Neni 10

1. Shoqëria, për përmbushjen e misionit të vet, ka të drejtë të vendosë mjete ose sisteme vrojtuese, sinjalizuese, audiovizive, pajisje ndërlidhjeje, si dhe të përdorë teknika të tjera, duke respektuar legjislacionin në fuqi.

2. Për ruajtjen e objekteve, shoqëria mund të përdorë edhe qen shërbimi, duke marrë masat përkatëse për parandalimin e pasojave që mund të sjellë ky lloj shërbimi.

Neni 11

1. Shoqëria ka në përbërje të personelit të ruajtjes dhe të sigurisë fizike drejtues teknikë dhe punonjës shërbimi, të cilët pajisen me lejen përkatëse për ushtrimin e profesionit.

2. Numri i personelit të shërbimit të shoqërisë së ruajtjes dhe të sigurisë fizike është deri në 5 për qind e efektivit të drejtorisë së policisë së qarkut, ku kjo shoqëri ushtron veprimtarinë, ndërsa numri i armatimit të saj është deri në 2 për qind të numrit të armatimit të efektivit të drejtorisë së policisë të qarkut.

Neni 12

1. Drejtuesi teknik është drejtuesi më i lartë teknik i shoqërisë dhe përgjegjësi ligjor për drejtimin, bashkërendimin dhe kontrollin e shërbimit të ruajtjes dhe të sigurisë fizike.

2. Kur, për shkaqe të arsyeshme drejtuesi teknik largohet nga shoqëria, kjo është e detyruar të njoftojë menjëherë drejtorin e policisë së qarkut, ku ushtron veprimtarinë, ndërsa për shoqëritë e kategorisë “c” njoftohet Drejtori i Përgjithshëm i Policisë. Në këto raste, shoqëria, brenda 45 ditëve, i paraqet autoritetit licencues kërkesën për zëvendësimin e drejtuesit teknik, si dhe për pajisjen e tij me lejen përkatëse, nëse ai nuk ka një të tillë.

Neni 13

Punonjësi i shërbimit vepron me cilësinë e rojes, të truprojes, të operatorit dhe kryen detyra të tjera të ngjashme me to, si dhe përmbush detyrat e ruajtjes dhe të sigurisë fizike, të përcaktuara në këtë ligj. Ai ka përgjegjësi ligjore për ruajtjen dhe sigurimin e objektit.

Neni 14

1. Pajiset me leje, për ushtrimin e profesionit të drejtuesit teknik, personi që plotëson këto kushte:

a) Ka zotësi të plotë për të vepruar.

b) Është shtetas shqiptar me banim të përhershëm në Republikën e Shqipërisë.

c) Ka kryer arsimin e lartë policor.

ç) Nuk ka qenë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi.

d) Është me moshë nën 60 vjeç.

2. Autoriteti për dhënien e lejes për ushtrimin e veprimtarisë së drejtuesit teknik të shoqërisë

është Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit.

3. Procedurat për dhënien e lejes bëhen sipas nenit 7 të këtij ligji.

Neni 15

1. Pajiset me leje, për ushtrimin e profesionit të punonjësit të shërbimit, personi që plotëson këto kritere:

a) Ka zotësi të plotë për të vepruar.

b) Është shtetas shqiptar me banim të përhershëm në Republikën e Shqipërisë.

c) Nuk ka qenë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi.

ç) Ka kryer arsimin e detyrueshëm.

d) Ka kryer shërbimin e detyrueshëm ushtarak.

dh) Plotëson kushtet ligjore për mbajtjen dhe përdorimin e armëve.

e) Është i aftë nga ana shëndetësore dhe ka gjatësi trupore mbi 160 cm.

ë) Plotëson kërkesat e nenit 16 të këtij ligji.

2. Autoriteti për dhënien e lejes për ushtrimin e profesionit të punonjësit të shërbimit është drejtori i policisë së qarkut, ku ushtron veprimtarinë shoqëria. Kërkesa për dhënien e lejes paraqitet nga shoqëria pranë drejtorisë së policisë së qarkut së bashku me dokumentacionin përkatës, të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Rendit Publik.

3. Kjo kërkesë shqyrtohet brenda 30 ditëve nga komisioni i shqyrtimit të lejeve pranë drejtorisë së policisë së qarkut, i cili, në përfundim, i paraqet autoritetit lëshues vlerësimin përkatës.

Neni 16

1. Punonjësi i shërbimit, para dhënies së lejes së ushtrimit të profesionit, i nënshtrohet një kursi kualifikimi për një periudhë kohe jo më pak se 15 ditë, nën drejtimin e drejtuesit teknik të shoqërisë dhe në përfundim të këtij kursi testohet nga një komision i posaçëm, i krijuar nga organi lëshues i lejes.

2. Punonjësi i shërbimit i nënshtrohet kurseve të kualifikimit të organizuara nga shoqëria, të cilat zgjasin jo më pak se 5 ditë në çdo vit kalendarik.

3. Programet e kualifikimit dhe të testimit hartohen dhe miratohen nga organet e Policisë së Shtetit, të specializuara për këtë shërbim.

4. Organet e Policisë së Shtetit në qark herë pas here mbikëqyrin kurset e kualifikimit të punonjësve të shërbimit të organizuara nga shoqëria.

Neni 17

Drejtuesi teknik i shoqërisë është i detyruar të njoftojë menjëherë organin e Policisë së Shtetit për çdo ngjarje që ndodh në objektet që ka në ruajtje shoqëria dhe çdo tre muaj njofton me shkrim për kryerjen e detyrave të ruajtjes dhe të sigurisë fizike, si dhe për problemet që kanë lindur.

Neni 18

1.Punonjësit e shërbimit kanë të drejtë të kërkojnë nga shtetasit zbatimin e rregullave të vendosura për hyrjen dhe daljen në objektin dhe/ose në territorin që ruajnë e të rregullave të tjera të përcaktuara në rregulloren e brendshme të objektit.

2. Kur vërejnë se në objektin që kanë në ruajtje ka ndodhur një vepër penale, menjëherë, në varësi të organizimit të shërbimit, njoftojnë organet e Policisë së Shtetit dhe marrin masa për ruajtjen dhe sigurimin e vendit të ngjarjes, deri në ardhjen e punonjësve të Policisë së Shtetit.

3. Punonjësit e shërbimit përdorin armët që kanë, në rastet dhe kushtet e përcaktuara në ligjin nr.8290, datë 24.2.1998 “Për përdorimin e armëve të zjarrit”.

4. Punonjësit e shërbimit kanë të drejtë dhe detyrë të ndalojnë personat që përgatiten të kryejnë, kanë kryer ose dyshohet se kanë kryer një vepër penale në objektin që ruajnë ose që ka lidhje me këtë objekt.

5. Punonjësit e shërbimit e kanë për detyrë t’u japin të dhëna punonjësve të Policisë së Shtetit

sa herë që iu kërkohet, për problemet e ruajtjes dhe të sigurisë së objektit.

6. Të drejtat dhe detyrat e përcaktuara për punonjësit e shërbimit në pikat 2 e 4 të këtij neni, zbatohen edhe në rastet e ruajtjes e të sigurimit të personave fizikë, si dhe të vlerave monetare e materiale dhe sendeve të çmuara në shoqërim gjatë lëvizjes.

Neni 19

Organet e Policisë së Shtetit e kanë për detyrë dhe të drejtë të kontrollojnë në çdo kohë kryerjen e shërbimit të ruajtjes dhe të sigurisë fizike, sipas rregullave të përcaktuara me udhëzim të Ministrit të Rendit Publik.

Neni 20

1. Shkelja e rregullave të parashikuara në nenet 5, 6, 11, 12, 14 e 17 të këtij ligji përbëjnë kundërvajtje administrative dhe shoqëria e ruajtjes dhe e sigurisë fizike dënohet me gjobë nga 100 000 deri në 200 000 lekë, ndërsa drejtuesi teknik i shoqërisë së ruajtjes dhe të sigurisë fizike dënohet me gjobë nga 20 000 deri 50 000 lekë. Të drejtën e gjobës e ka drejtori i policisë së qarkut.

2. Shkelja e rregullave të parashikuara në nenet 8 dhe 18 të këtij ligji, përbën kundërvajtje administrative dhe punonjësi i shërbimit të shoqërisë dënohet me gjobë nga 5 000 deri 10 000 lekë. Të drejtën e gjobës e ka drejtori i policisë së qarkut.

Neni 21

1. Shoqërisë së ruajtjes dhe të sigurisë fizike i hiqet licenca nga autoriteti që e ka lëshuar atë, në rastet kur:

a) vërtetohet se licenca është marrë në bazë të dokumenteve dhe të të dhënave të falsifikuara;

b) është dënuar administrativisht me gjobë për të njëjtën shkelje në mënyrë të përsëritur;

c) nuk fillon ushtrimin e veprimtarisë për një periudhë 3-mujore nga data e marrjes së licencës;

ç) nuk shlyen detyrimet financiare, të parashikuara në ligj.

2. Drejtuesit teknik i hiqet leja nga autoriteti lëshues kur:

a) vërtetohet se leja është marrë në bazë të dokumenteve dhe të të dhënave të falsifikuara;

b) është dënuar administrativisht me gjobë për të njëjtën shkelje në mënyrë të përsëritur;

c) kanë ndryshuar kushtet e kërkuara në nenin 14 të këtij ligji;

ç) nuk fillon ushtrimin e veprimtarisë për një periudhë 3-mujore nga data e marrjes së licencës.

3. Punonjësit të shërbimit i hiqet leja e ushtrimit të profesionit kur:

a) vërtetohet se leja është marrë në bazë të dokumenteve dhe të të dhënave të falsifikuara;

b) është dënuar administrativisht me gjobë për të njëjtën shkelje në mënyrë të përsëritur.

c) kanë ndryshuar kushtet e kërkuara në nenin 15 të këtij ligji.

Neni 22

1. Objektet më të rëndësishme shtetërore, të cilat përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, ruhen dhe sigurohen me punonjës të Policisë së Shtetit.

2. Rregullat për ruajtjen dhe sigurimin e këtyre objekteve nuk i nënshtrohen këtij ligji.

Neni 23

Ligji nr.7550, datë 20.1.1992 “Për policinë e objekteve”, ligji nr.7696, datë 7.4.1993 “Për shërbimin e rojeve civile” dhe ligji nr.7985, datë 13.9.1995 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7696, datë 7.4.1993 “Për shërbimin e rojeve civile”” shfuqizohen.

Neni 24

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2993, datë 4.5.2001 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë
Rexhep Meidani.